



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 31.10.2018,
e cila filloi në orën 12:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Nol Nushi (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Eman Rrahmani (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Valbona Petrovci, e pavarur, Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Sami Salihu (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Migjen Shala (PDK), Uran Ismaili (PDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Florida Canolli (PDK), Sokol Berisha (AAK), Yll Bogaj (AAK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Suzan Kika (AAK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR-AA), Sami Boroci, (AKR-AA), Arbenita Murseli (AKR-AA), Adelina Fazliji (AKR-AA), Rifat Deri (AKR-AA), Bukurie Canolli (LB) dhe Baton Dushi (Nisma).

Munguan: Visare Gashi (PSD), Milazim Vitija (LDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Leutrim Retkoceri (PDK).

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe të KFOR-it dhe përfaqësuesit e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesuesi i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin e pikave të rendit të ditës, Kryesuesi kërkoi që të hedhet në votim propozimi për prezantimin: "Për mundësi të barabartë në punësim për personat me nevoja të veçanta", që do të prezantohet nga përfaqësuesit e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta.

Kryesuesi konstatoi se më 35 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi, që prezantimi nga përfaqësuesit e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta të bëhet para se të fillohet me rendin e ditës.

Lidhur me marrjen e disa iniciativave dhe paraqitjen e pikëpamjeve dhe mendimeve, si dhe të disa propozimeve për zgjidhjen e problemeve të identifikuar që ndërlidhen kryesisht me personat me nevoja të veçanta, të pranishmit i informuan Ramadan Salihu dhe Mehreme Llumnica, anëtarë të Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta.

Leonora Shabani - Bajraktari tha se në gjithë territorin e Kosovës vazhdojnë t'u shkelen të drejtat personave me nevoja të veçanta. Po të jesh familjare e një fëmije, apo një personi me nevoja të veçanta, është jashtëzakonisht e rëndë në këto kushte dhe rrethana. Për fat të keq, shoqëria jonë nuk ka bërë deri tash asnjë gjë, më së paku kujdesemi për fëmijët, sidomos për ata që janë me nevoja të veçanta.

Shefki Gashi propozoi që numri i të punësuarve, në përqindje prej 0,4%, të paktën deri në përfundim të këtij viti, për Komunën e Prishtinës të bëhet 5%, duke pasur parasysh të gjitha drejtoritë, shkollat dhe institucionet e ndryshme, ta shohin mundësinë dhe ta bëjmë një zgjidhje më të mirë për këta persona. Ai kërkoi nga të gjithë anëtarët e Kuvendit që ta përkrahin dhe ta votojnë këtë propozim.

Vlora Dumoshi kërkoi nga të pranishmit që kjo temë të mos politizohet. Ne si institucion duhet me e ngritur zërin, pasi të gjitha dokumentet janë, si Plani i veprimit, i cili është aprovuar në këtë Kuvend, pra ne duhet t'i kryejmë obligimet tona karshi këtyre njerëzve në nevojë.

Adelina Fazliji theksoi se në Komunën e Prishtinës nuk është i punësuar asnjë person me nevoja të veçanta. Fillimisht, dua t'i adresojë kërkesat e tyre, se duke u nisur prej kryeqytetit, ata nuk kanë qasje as në rrugë, etj. Apeloj që t'iu dalim në ndihmë sa më shumë, dhe të mos i përfshijmë interesat partiake kur bëhet fjalë për persona me nevoja të veçanta.

Vala Peshku i falënderoi anëtarët e Komitetit konsultativ për personat me nevoja të veçanta për prezantimin e këtij raporti. Ajo i lexoi rekomandimet, si në vijim:

1. Që zyrtarët në nivel qendror dhe në atë lokal, të jenë fokusi parësor i avokimit për zbatim të kornizës ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuara;
2. Ndërmarrjet në përgjithësi, si punëdhënësit primarë potencialë për personat me aftësi të kufizuara, të jenë fokusi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për punësim;
3. Të ngrihet vetëdija e përfaqësuesve të ndërmarrjeve publike dhe kompanive private, lidhur me ligjin dhe kërkesat e tij për punësim të personave me aftësi të kufizuara;

4. Të ngrihet vetëdija e ndërmarrjeve dhe kompanive që kanë të punësuar persona me aftësi të kufizuara, mbi të drejtën e tyre për ditë shtesë të pushimit.

Fiknete Bejta tha se mundësitë për punësim nuk mund t'i krijojmë vetëm në sektorin publik, mirëpo të drejtohem i dhe të orientohejmë të zhvillohen edhe këta si ndërmarrës, sepse njoh shumë ndërmarrës të suksesshëm që vijnë nga ky komunitet. Prandaj, i kisha sugjeruar Komunës të gjejë disa fonde, me ndihmën e donatorëve, dhe t'i orientojë këta persona, sepse shumë prej tyre janë shumë të kualifikuar dhe mund t'i zhvillojnë bizneset e tyre.

Kryesuesi tha se nga diskutimet e parafolësve, u konstatua se sa i përket çështjes së personave me nevoja të veçanta, ekzistojnë ligjet, ekziston plani, pra dhe detyrë e jona është që të kujdesemi që ato të zbatohen. Po ashtu ekzistojnë edhe ato rekomandime që i dëgjuam të gjithë. Është ndoshta pak edhe e palogjikshme që në këtë seancë të votohet diçka që ishte vetëm prezantim i raportit.

Eman Rrahmani tha se të paktën deri në fund të këtij viti, të zbatohet ligji dhe të punësohen 2% e këtyre personave, që e ka obligim edhe me ligj. Kishte me qenë mirë që Kuvendi të dalë me një kërkesë, që deri më 1 janar ky ligj të plotësohet dhe këta njerëz të punësohen.

Genc Sherifi tha se jemi për votimin e këtij raporti nga Hendikos dhe rekomandimet që dalin nga ky raport.

Halim Halimi u shpreh se detyrë e jona si asamblistë, si Kuvend, është me e miratuar një rekomandim, sepse me marrë vendim, vendimet janë të obligueshme. Kështu që ne duhet të marrim rekomandim, e besoj se edhe Zyra ligjore pajtohet se mundemi me marr rekomandim, me ju rekomanduar institucioneve komunale, me u zbatuar rekomandimet të cilat u lexuan më parë.

Egzon Azemi tha se nëse një realizim prej shifrës 2% për punësimin e personave me nevoja të veçanta nuk mund të bëhet në Komunën e Prishtinës, në drejtoritë e sajë, atëherë besoj se shumë e lehtë është të bëhet në ndërmarrjet publike që i menaxhon Komuna e Prishtinës. Besoj se kuota prej 2% ishte dashur me qenë vendim i Kuvendit komunal, që i obligon të paktën ndërmarrjet publike që ta respektojnë këtë vendim.

Vala Peshku tha se Asambleja, ekzekutivi dhe Komuna e Prishtinës, duhet të jenë në përputhje me ligjin. Nuk kemi pse të nxjerrim këtu vendime, sepse ato janë vendime në ajër, andaj i kemi rekomandimet, i votojmë ato edhe duhet secili prej nesh individualisht edhe si grup me punuar në këtë drejtim.

Kryesuesi konstatoi se të gjitha grupet parlamentare u pajtuan që të miratohet propozimi i lartcekur.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 38 vota për, u miratua raporti nga Hendikos, me rekomandimet e lartcekura, dhe rritja e përqindjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara në të ardhmen në Komunën e Prishtinës.

Kryeruesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, propozoi që në rend dite të futet edhe pika për këmbimin e pronës në pronësi të personave fizikë, pikë e cila në mbledhjen e kaluar nuk është miratuar. Kjo lëndë nga aspekti ligjor është në rregull, andaj propozoj që ta procedojmë më tutje.

Osman Billaca, përfaqësues i ekzekutivit, propozoi që në rend dite të futet propozimi i Shoqatës së të Burgosurve Politikë, për ngritje e një obelisku për nder të 50-vjetorit të Demonstratave dhe të rënëve të vitit 1968.

Vjosa Hamiti - Krasniqi kërkoi nga Zyra ligjore një interpretim rreth vendimeve për këmbimin e pronave dhe disa paqartësive që kanë të bëjnë me pronat në pronësi të Komunës.

Rifat Deri propozoi që në rend dite të futet edhe propozimi për ngritjen e një përmendoreje ose lapidari për prishtinasit e pushkatuar te vendi i quajtur Strelishtë afër Taukbahçes.

Halim Halimi tha se çdo propozim që sillet në Kuvend, duhet të ketë edhe material, andaj si mund të vendosë Kuvendi kur nuk ka asnjë material.

Ai kërkoi që për të gjitha propozimet të sillen edhe materialet nga drejtoritë përkatëse.

Eman Rrahmani tha se sa i përket propozimit të drejtorit të Drejtorisë së Pronës, të futjes së serishme të pikës e cila nuk ka kaluar në seancën e kaluar, besoj që drejtoresha e Drejtorisë së Kadastrit i ka dhënë të gjitha informacionet se si duhet të veprohet, në mënyrë që të kalojë ligjshëm kjo pikë e rendit të ditës.

Agim Gashi propozoi që të shtyhet pika e katërt e rendit të ditës, pasi që kur të miratohet versioni i fundit i Rregullores për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (pika e dytë), vjen në rend Plani i veprimit, dhe faktikisht harmonizohet dhe miratohet në harmoni me Rregulloren.

Ardian Olluri, në emër të ekzekutivit, e përkrahu propozimin e z. Gashi, që pika e katërt e rendit të ditës "Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në komunën e Prishtinës" të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e drejtorit të Drejtorisë së Pronës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve: Nexhmi Nezir Kastrati, Aza Miftar Hasanaj, Shahindere Ahmet Xharra, Merlin Bahri Zhubi, Ismet Ilaz Shkodra, Xhelal Ilmi Rroka, Egjyment Sylejman Mehmeti, Mexhait Idriz Reçi, Hasan Hajriz Beselica, Fatmire Abdyl Berisha, Astrit Hasan Mekuli, Bujar Izet Surdulli, Shemsedin Sebadin Klaiqi dhe propozimin e z. Gashi që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për, 1 kundër dhe 4 abstenime, u miratuan propozimet që pikat e propozuar të futet në rend të ditës për shqyrtim dhe pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 35 vota për, u miratua propozimi i z. Osman Bllaca për caktimin e një lokacioni për vendosjen e Obeliskut për nder të 50 vjetorit të demonstratave dhe të rënëve në vitin 1968.

Lidhur me propozimin e z. Rifat Deri, që si pikë e rendit të ditës të jetë propozimvendimi për ngritjen e një përmendoreje ose të lapidarit për prishtinasit e pushkatuar te vendi i quajtur Strelishte, afër Taukbahçes, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se ky propozim paraprakisht duhet të kalojë përmes drejtorisë përkatëse dhe më pas të procedohet në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, u miratua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM 3);
4. Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës;
5. Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Herticëve";
6. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir (Mehmet) Haxhisë;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Nexhmi (Nezir) Kastrati dhe Aza (Miftar) Hasanaj;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Fejzullahit dhe Kadri Berishës;
10. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitet Amerikan në Kosovë (AUK);
11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut;
12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit;

13. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapcanit;
14. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës;
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut dhe Vehbi (Bajram) Aliut;
16. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Muhamed (Beqir) Bajgorës dhe Nuhi (Ilaz) Bajgorës;
17. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshetit;
18. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut dhe Shefqet (Mustafë) Rexhepit;
19. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Kosovës;
20. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Fondacionin për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pforten";
21. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
22. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut kushtuar 50-vjetorit të demonstratave të vitit 1968 në Kosovë;
23. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Ismajl Vrapcit dhe Ramadan Vrapcit;
24. Pyetje dhe përgjigje;
25. Të ndryshme.

Pika parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 kundër, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Lidhur me Propozimvendimin për konsulta paraprake për Propozimrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit.

Agim Gashi tha se kjo rregullore në aspektin teknik ka disa gabime logjike, që nuk është mirë të shkojë në diskutim publik me ato gabime.

Vërejtje kishte te neni 5, pika 2, te neni 4, pika 2, shkronja k dhe te neni 11, pika 4.

Ai kërkoi që para se të publikohet kjo rregullore për diskutim publik, të përmirësohen dhe të korrigojohen këto nene.

Vala Peshku tha se edhe ne e përkrahim këtë Propozimrregullore që të shkojë në diskutim publik.

Eman Rrahmani theksoi se ne e mbështesim në parim këtë Propozimrregullore që të shkojë në diskutim publik, por kërkojmë që diskutimet publike të mos mbahen këtu në Kuvendin komunal, por të mbahen në lagje apo në shkolla.

Sami Boroci tha se edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Propozimrregullore që të dalë në diskutim publik. Jemi që në diskutim publik të përfshihen sa më shumë akterë, e jo vetëm të bëhen diskutime publike formale.

Kryesuesi konstatoi se me propozimin e dhënë nga z. Agim Gashi, më 34 vota për, u miratua Vendimi për konsulta paraprake për Propozimrregulloren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Pika e tretë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik-30 shtator 2018 (TM 3)

Lidhur me Raportin financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM 3), në pika të shkurtra i njoftoi Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

Agim Gashi tha se paraprakisht në Komitetin për politikë dhe Financa u pajtuam që pjesë e raportit me shkrim me qenë edhe vlera e bartjes së mjeteve dhe projekteve të realizuara në periudhën janar-shtator, por kjo nuk është bërë, andaj dhe ky raport është i mangët, ka mangësi bazike. Po ashtu, është dashtë që të jetë prezent edhe kryetari i Komunës për të raportuar për punën periodike që e ka bërë qeveria komunale, e ka përgjegjësi ligjore, por ai përsëri vazhdon të mungojë.

Sa i përket fushës së të hyrave, më vjen mirë që në periodën e tretë është përmirësuar sasia e të hyrave dhe e ka mbërri përqindjen 67.75% të realizimit. Kjo e ka përmirësuar pak a shumë fushën e të hyrave të mjeteve, gjë që ia ka mundësuar qeverisë komunale që t'i realizojë politikat e veta të planifikuara. Po ta analizojmë organizimin e projekteve, del se shpenzimet janë shumë të ulëta, sidomos në fushat kur përgjegjësia bie direkt mbi qeverinë komunale, siç janë transferet dhe subvencionet dhe investimet kapitale. Tek të hyrat e mjeteve, vlen të

theksohet se qeveria komunale duhet të bëjë diçka që ta ndryshojë sasinë e të hyrave për shërbimet e ndryshme.

Ne presim që këto politika të jenë sa më racionale, të bashkëpunohet në nivel pozitivë opozitë, sepse këtu jemi për atë qëllim.

Vala Peshku theksoi se bartja e buxhetit nuk varet nga Drejtoria e Financave apo nga Komuna, por varet nga thesari, kështu funksionojnë raportet financiare dhe numrat me evidentime. Raportet financiare nuk funksionojnë mbi atë çka dinë, po atë çka e paraqet dhe çka e fakton.

Eman Rrahmani tha se kam kërkuar nga Drejtoria e Financave që të na sillet një dokument, që ta dimë se sa është norma e interesit apo diferenca që është paguar, për shkak që disa kompani, apo ndaj disave që ka pasur obligime, nuk janë kryer obligimet dhe janë marrë te hollat me përmbarues.

Tek te hyrat, pra janë të hyra të paqëndrueshme, që nuk tregojnë një stabilitet, për shkak se ka disa zëra ku tejkalohen jashtëzakonisht shumë, kurse në të tjerat nuk kemi të hyra fare. Këtu thuhet se buxheti është shpenzuar 56.73%, mirëpo e vërteta është që për 9 muaj është shpenzuar 47.56%, por realiteti është se janë shpenzuar vetëm 22.75% për këta 9 muaj. Unë kam një shqetësim tash, se duke e marrë parasysh që këto vlera kaq të vogla të shpenzimeve kapitale edhe afatit të shkurt kohor për realizmin e këtyre projekteve, kanë me u bërë pagesa pa u përfunduar punët, kanë me u bërë punë që nuk mbikëqyren, sikurse që ndodh në infrastrukturën rrugore etj.

Fiknete Bejta fillimisht e falënderoi drejtoreshën për këtë raport, duke thënë se ky raport është më i miri krahasuar me raportet paraprake, edhe pse ky raport tregon performancë të dobët financiare, por nuk besoj që i takon drejtoreshës së Financave, mirëpo drejtorëve dhe drejtorive të tjera. Ky raport tremujor buxhetor tregon mungesë të politikave komunale, mosrealizim të buxhetit, dhe vërehet një përmirësim i lehtë i financave e të hyrave në këtë periudhë, e cila prapë nuk mund ta minimizojë hapësirën për të qenë optimist se do të realizojë të hyra më shumë për periudhën e ardhshme. Pra, kjo vjen si pasojë e mungesës së planeve dhe strategjive të mjeteve vetanake. Kjo tregon se Prishtina nuk ka performancë të mirë buxhetore dhe as nuk po bën përmirësime në këtë fushë. Shifrat që janë prezantuar në këtë raport buxhetor tregojnë qartë se kemi dështim në katër aspektet që prezanton ky raport, pra në hartimin e mjeteve vetanake sipas projeksionit financiar, ngecje në shpenzimet buxhetore, mosrealizim të investimeve, si dhe shtim të detyrimeve kontingjente, të njohura si paditë e të tjerëve të Komunës.

Mirsad Vitia, për këtë raport buxhetor për periudhën korrik-shtator, kryesisht u fokusua në tri drejtori, në Drejtorinë e Administratës, në Drejtorinë e Pronës dhe në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik. Lidhur me këtë ceku se për këtë periudhë kohore janë shpenzuar shumë pak mjete për realizimin e projekteve, edhe përkundër asaj që për këto projekte kanë qenë mjetet e zotuara.

Haki Dragusha tha se në bazë të këtij raporti shihet se për Drejtorinë e Shëndetësisë janë shpenzuar shumë pak mjete dhe nuk dihet se ku është problemi. Në këtë raport, si projekte të përshkruara janë vetëm dezinfektimi dhe renovimet dhe asnjë projekt tjetër nuk është realizuar që 10 muaj.

Shefqet Osmani tha se sa i përket këtij raporti, shihet se shifra rreth raportit të detyrimeve kontingjente nga Zyra e përfaqësimit juridik, është shumë alarmante dhe shumë shqetësuese, ku janë më se 593 lëndë të këtij viti, prej tyre 17 milion euro është vlera financiare me të cilat është paditur Komuna e Prishtinës. Kjo është shumë shqetësuese dhe për këtë kisha dashur me pasur një shpjegim.

Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, tha se ka padi që janë prej vitit 2015 e këndeje, të cilat nuk mundemi me i paragjykuar, e as nuk mundemi me e ndalur pretendimin e një pale për me paditur Komunën dhe me kërkuar një shumë të mjeteve.

Nol Nushi theksoi se nuk do të ishte mirë që të bëhen kritika selektive, sidomos rreth disa zërave buxhetore për Drejtorinë e Shëndetësisë. Sipas raportit, shihet se në këtë drejtori një zë buxhetor është i paraparë për pajisje mjekësore për QKMF dhe QMU, andaj do të ishte jo korrekte të thuhet se për mosrealizimin e disa projekteve ka ndikuar edhe drejtori i Drejtorisë së Investimeve Kapitale, kur po shihet se edhe në disa drejtori të tjera ka pasur pak realizime të projekteve.

Lidhur me vërejtët dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit lidhur me Raporti financiar buxhetor, sqarime të nevojshme dhanë Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, dhe Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave.

Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 12 kundër, u miratua Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2018 (TM 3).

Pika e katërt

Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Lidhur me Projektstatutin e Qendrës Kulturore të Prishtinës, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës.

Halim Halimi vërejtje bëri në nenin 3, pika 1, dhe propozoi që të jetë me këtë formulim: QKP-ja është institucioni kryesor dhe ka degët e veta që funksionojnë në kuadër të institucionit kryesor.

Shefki Gashi kërkoi të dijë se kjo qendër kulturore a është ndonjë drejtori, organizatë, apo është OJQ, përderisa burimi i mjeteve është edhe prej buxhetit, edhe prej donacioneve, prej të hyra vetanake dhe prej subvencione.

Vlora Dumoshi tha se është për t'u vlerësuar kjo nismë për projektstatutin e kësaj qendre, por është shqetësuese se si mund ta krijojmë një qendër të tillë pa pasur mjete buxhetore, pa pasur një plan më afatgjatë.

Adrian Berisha theksoi se është për ta përgëzuar këtë nismë për krijimin e Qendrës Kulturore të Prishtinës, dhe mendoi se është më se e nevojshme, për arsye se Qendra Kulturore e Prishtinës do të kishte arritur me e krijuar një organizatë të përbashkët të funksionimit të të gjitha qendrave nën një ombrellë, në një të ardhme të afërt.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës.

Me propozimin e dhënë nga z. Halimi, kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 7 kundër, u miratua Projektstatuti i Qendrës Kulturore të Prishtinës.

Pika e pestë

Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Horticëve".

Yll Rugova, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, tha se marrëveshjen që e ka bërë Komuna e Prishtinës me familjen Aliu, është që emërtimi i rrugës të jetë "Shkollat e Horticëve".

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin e emrit të rrugës "Hasan Ramadani" në rrugën "Shkollat e Horticëve".

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e KKSB-së.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir (Mehmet) Haxhisë.

Lidhur me Propozimvendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir (Mehmet) Haxhisë, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës.

Eman Rrahmani tha se këtë këmbim të pronës nuk mund ta votojmë, sepse konsiderojmë që një votim i tillë është i kundërligjshëm, pasi që ne nuk kemi dokument që e vërteton këtë, që do të thotë që nuk kemi certifikatë të pronësisë së Komunës.

Sami Boroci tha se me rastin e këmbimit të këtyre pronave, ka detaje të cilat ne nuk po i kuptojmë në disa raste, prona e cila, d.m.th. po merret një pronë dhe po jepet një pronë, e shohim p.sh. Zona kadastrale Matičan ose Muhaxhirët, ndërsa ajo çka ne po duam ta dimë është pak më saktë, ku gjenden këto prona.

Kumrie Shabani - Ramadani u shpreh se ne po i kemi të paqarta disa gjëra rreth këtyre pronave, por për hir të qytetarëve që kanë pritur dje dhe janë duke pritur edhe sot, kemi vendosur t'i votojmë.

Shefki Gashi, tha se unë do ta votoj këtë këmbim të pronës, por kërkoj që për çdo ngutje, për çdo mungesë të dokumentacionit të trashëgimtarëve të ndryshëm, të pretendentëve të ndryshëm, përgjegjësinë ta marrë Drejtoria e Pronës.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime të nevojshme dhanë Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, dhe Ardian Olluri, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së pa luajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Zeqir (Mehmet) Haxhisë.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Nexhmi (Nezir) Kastrati dhe Aza (Miftar) Hasanaj.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve: Nexhmi (Nezir) Kastrati, Aza (Miftar) Hasanaj, Shahindere (Ahmet) Xharra, Merlin (Bahri) Zhubi, Ismet (Iliaz) Shkodra, Xhelal (Ilmi) Roka, Ergjymet (Sylejman) Mehmeti, Mexhait (Idriz) Reçi, Hasan (Hajriz) Beselica, Fatmire (Avdyl) Berisha, Astrit (Hasan) Mekuli, Bujar (Izet) Surdulli dhe Shemsedin (Sebaedin) Klaiqi.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Fejzullahit dhe Kadri Berishës.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Fatmir Fejzullahit dhe Kadri Berishës.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK).

Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, tha se meqë ne po e japim për 50 vjet në shfrytëzim, së paku është propozim i imi, që ne të kërkojmë nga ky institucion arsimor që t'i japin ndonjë bursë së paku ndonjë studenti të familjeve të dëshmorëve, ose dikujt tjetër.

Agim Gashi theksoi se nuk do të ishte mirë që atë institucion ta kushtëzojmë, sepse neve amerikanët nuk na kanë kushtëzuar kurrë, që një shekull e 10 vjet, kurrë nuk na kanë kushtëzuar për kurrgjë, por gjithmonë na u kanë gjetur pranë.

Vala Peshku tha se ky institucion është organizatë joprofitabile, andaj me kontaktet dhe me lidhjet që ka kryetari i Komunës, po ashtu edhe nënkryetari, me këtë organizatë, mundemi tutje me biseduar për ndonjë marrëveshje të mundshme, për përkrahjen e studentëve të Komunës së Prishtinës me disa bursa.

Egzon Azemi tha se do të ishte shumë e nevojshme që t'i dërgojmë disa rekomandime ndaj AUK-ut, p.sh. qasjen për krejt studentët e Universitetit të Prishtinës në bibliotekën e AUK-ut. Gjithashtu, p.sh. mund ta bëjmë edhe mbase një kërkesë si Kuvend, që nga AUK-u të ndahen edhe 20 bursa për disa kategori, si për familjar të dëshmorëve, të rasteve sociale etj.

Suzan Kika u shpreh e pajtimit me propozimin e z. Pacolli, nënkryetar, por nuk do të thotë ata me qenë ose fëmijë të dëshmorëve, ose raste sociale, mirëpo fëmijët që dallohen në diçka.

Shefki Gashi tha se nuk do të ishte mirë që ta kushtëzojmë këtë institucion, duk e ditur angazhimin dhe ndihmën që e ka dhënë shteti amerikan për ne. Ne do ta votojmë këtë propozimvendim pa asnjë kusht.

Sami Boroci shprehu mendimin se do të ishte mirë që të trajtohen këto propozime dhe këto kërkesa të Kuvendit, përndryshe, këtë propozimvendim ne do ta votojmë.

Drilon Pireva tha se në mbledhjen e KPF-së është dashur me i diskutuar këto, po mendoj që tash më është vonë, ose duhet me votuar për me e shtyrë, ose duhet me e votuar propozimin komplet qysh është kështu, pa kushte.

Vlora Dumoshi tha se ne si Kuvend do ta marrim vendimin që AUK-së t'ia japim objektin në shfrytëzim, sepse ata e parashohin të investojnë në atë pjesë, pastaj unë mendoj që duhet me u bërë një marrëveshje e mirëkuptimit në mes të Komunës së Prishtinës, Kryetarit dhe universitetit atje, për tjerat kushte të cilat mund të propozohen.

Fadil Gashi tha se nuk do të ishte korrekte që AUK të kushtëzohet për ndarje të bursave, andaj propozoj që dhënia në shfrytëzim të objektit të votohet pa asnjë kusht.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të objektit të ish-Konviktit të nxënësve të SHM "Gjin Gazulli" Universitetit Amerikan në Kosovë (AUK).

Pika e njëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Meliha (Zeqir) Rrmokut.

Pika e dymbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Nexhat (Shaban) Dumnicës dhe Liman (Beqir) Jasharit.

Pika e trembëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapçanit.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Hazir (Jahir) Tahirit dhe Qamile (Hazir) Vrapçanit.

Pika e katërbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Bedri (Smajl) Prishtinës dhe Durim (Bedri) Prishtinës.

Pika e pesëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut dhe Vehbi (Bajram) Aliut.

Kryesuesi konstatoi se më 27 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Remzi (Bajram) Aliut dhe Vehbi (Bajram) Aliut.

Pika e gjashtëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Muhamed (Zeqir) Bajgorës dhe Nuhi (Ilaz) Bajgorës.

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Muhamed (Zeqir) Bajgorës dhe Nuhi (Ilaz) Bajgorës.

Pika e shtatëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshitit.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Nezir (Zeqir) Xhemshitit.

Pika e tetëmbëdhjetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut dhe Shefqet (Mustafë) Rexhepit.

Kryesuesi konstatoi se më 30 vota për dhe 2 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Ujup (Mustafë) Salihut dhe Shefqet (Mustafë) Rexhepit.

Pika e nëntëmbëdhjetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Policinë e Kosovës.

Pika e njëzetë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Fondacionin për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfofen".

Kryesuesi konstatoi se më 31 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Fondacionin për mbrojtjen e kafshëve "Vier Pfofen".

Pika njëzetënjë

Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 33 vota për u miratua Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Pika njëzetedy

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut kushtuar 50-vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, me 33 vota për u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e obeliskut kushtuar 50 vjetorit të Demonstratave të vitit 1968 në Kosovë.

Pika njëzetetre

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Ismajl Vrapcit dhe Ramadan Vrapcit.

Kryesuesi konstatoi se më 29 vota për dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private në pronësi të Ismajl Vrapcit dhe Ramadan Vrapcit.

Pika njëzetekatër

Pyetje dhe përgjigje.

Eman Rrahmani, pyetje për Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës:

- Pse nuk u mbajtën premtimet e kryetarit, të cilat u dhanë gjatë fushatës elektorale, janë katër çerdhe të reja për vitin 2018, të premtuara nga kryetari, asnjë e realizuar, dhe janë dy çerdhe të cilat kanë pasur të funksionalizohen, ajo në "Kodër të Trimave" dhe në "Tophane" dhe nuk janë funksionalizuar?
- Pse po vonohet kaq shumë ndërtimi i tregut, këtu afër objektit të Komunës, pra largimi dhe ndërtimi i objektit të ri?
- Largimi dhe ndërtimi i ri i Tregut të kafshëve dhe shpezëve, i cili duhet të largohet prej aty, për shkak se banorët të cilët jetojnë aty, e kanë të jetën të pamundur, sepse janë të rrezikuar prej epidemive të ndryshme nga mбетjet aty.
- Çka është duke ndodhur me mos realizimin e premtimeve, siç kanë qenë për Strehimoren regjionale për trajtimin e qenve endacakë, krijimin e rrjetit primar të shtigjeve për çiklistë dhe programi "Rentubait", krijimi i shtegut për çiklistë Gërmi - Badovc etj.?

Selim Pacolli tha se unë nuk marr përgjegjësi për premtimet e dhëna nga Shpend Ahmeti, marr përgjegjësi për programin që e kemi të përbashkët, e këto pika nuk janë në atë program dhe këto pyetje ia parashtroni kryetarit Shpend Ahmeti.

Mbledhja përfundoi në orën 16:53.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi



Kryesuesi i Kuvendit
Agim Kuleta

Faqe 16 nga 16

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.pristina-komuna.org>